



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 03, datë 01.12.2015

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “NDËRTIMI I VOLUMIT SHTESË 2 KATE, PRANË GODINËS EKZISTUESE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, si dhe Vendimit Nr. 1, datë 23.03.2015 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i volumit shtesë 1 kat me funksion “Sallë Konferencash” dhe rikonstrukcion i godinës ekzistuese të Ministrisë së Punëve të Brendshme”, në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit”, me propozimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i volumit shtesë 2 kate, pranë godinës ekzistuese të Ministrisë së Punëve të Brendshme”, me propozimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Njesisë së Qeverisjes Vendore.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

